



Titulli i projektit: Former à l'enseignement du français écrit en contexte plurilingue et transeuropéen: enjeux, modèles, pratiques innovantes et inclusives (DIDAFÉ)

Referencë: 2023-1-FR01-KA220-HED-000158111

Kohëzgjatja: 36 muaj (01/09/2023- 31/08/2026)

Programi: Projekt Erasmus+ KA220-HED-Partneritete bashkëpunimi në arsimin e lartë

Buxheti total: 250.000 euro

Projekti DIDAFÉ i financuar nga Bashkimi Evropian, synon të trajtojë mësuesit dhe mësuesit e ardhshëm të gjuhës frënge në mësimdhënien e shkrimit. Për ta bërë këtë, bëhet fjalë (i) të përshkruhen politikat arsimore dhe gjuhësore të vendeve partnere, (ii) të identifikohet raporti me gjuhët, me gjuhën frënge të shkruar dhe me mësimdhënien e saj të grupeve të synuara, si dhe praktikrat e tyre të mësimdhënies së gjuhës frënge të shkruar, (iii) të zhvillohen burime arsimore dhe (iv) të forcohen mobilitetet e mësimdhënies, të trajnimit dhe të kërkimit.

Në përfundim të këtij projekti, ndër të tjera janë planifikuar katër arritje konkrete: (i) krijimi i një platforme dixhitale për ndarjen e burimeve, (ii) organizimi i një seminari ndëruniversitar me fokus mësimdhënien e gjuhës frënge të shkruar në kontekstet shkollore dhe kontekstet jashtëshkollore, (iii) zhvillimi i një moduli të edukimit të vazhdueshëm mbi mësimdhënien e gjuhës frënge të shkruar, (iiii) botimi i një grupi artikujsh shkencorë mbi temat e trajtuara.

Projekti DIDAFÉ organizohet në 5 module pune:

-Moduli 1: Manaxhimi i projektit

-Moduli 2: Kontekstet e të ushtruarit të mësimdhënies së gjuhës frënge

-Moduli 3: Praktika efektive: shkëmbime përvojash

-Moduli 4: Përmbajtje dhe inxhinieri pedagogjike: kurrikula, burime arsimore

-Moduli 5: Struktura (dispozitivë) eksperimentale.

Koordinator:

Universiteti i Bordeaux-INSPÉ (Francë)

Partnerët:

Universiteti i Bordeaux Montaigne (Francë)

Universiteti i Tiranës (Shqipëri)

Universiteti i Bukureshtit (Rumani)

Universiteti i Novi Sad-it (Serbi)

Partnerët e asociuar:

Rrjeti Néo-Aquitain për Frankofonitë (FrancophoNéA)/Francë,

Qendra rajonale frankofone për kërkime të avancuara në shkenca sociale (CEREFREA)/Rumani,

Shoqata e mësuesve të gjuhës frënge në Shqipëri,

Shoqata e mësuesve të gjuhës frënge në Serbi,

Shoqata e mësuesve të gjuhës frënge në Rumani.